

ZYRA CIVILE NDËRKOMBËTARE (ZCN) DHE EULEX-i: PUSHTETI, ZINXHIRI KOMANDUES DHE PËRGJEGJËSIA

Kur shumëkush po priste që UNMIK-u të shkonte pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008, rruga iu hap një procesi tjetër, të cilin Lëvizja VETËVENDOSJE! e kishte parashikuar me kohë: UNMIK-ut që po mbetet do t'i shtohet edhe një tjetër mission ndërkombëtar i dërguar nga Bashkimi Evropian. Skema dhe struktura e përgjegjësisë së faktorëve ndërkombëtarë që po qeverisin me Kosovën, është bërë edhe më e ndërlikuar se ç'ka qenë.

Kur misionit aktual të OKB-së t'i shtohet edhe ky nga BE-ja, qytetari i Kosovës do ta ketë shumë më të vështirë identifikimin e përgjegjësisë institucionale, prandaj edhe orientimin e veprimit të tij politik. Misioni që po vjen do ta zëvendësojë UNMIK-un në një rreze të caktuar kompetencash: ai do të qeveris me rendin dhe ligjin në Kosovë. Kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij misioni do të jenë të natyrës ekzekutive, siç do të argumentohet në vazhdim. Kjo e shndërron Kosovën në një vend pa demokraci e liri politike kolektive. Demokracia dhe liria jonë politike do të përfundojnë nën fuqinë e një pushteti që nuk është i zgjedhur nga ne, por na qeveris; që nuk na jep llogari, por na kontrollon dhe merr vendime për ne. Rekomandimet e bëra nga ne iu përkasin institucioneve politike, nëse ato janë ose duan të bëhen institucione të një vendi sovran. Në të kundërtën, qytetari do të ketë arsye të plotë që ta zgjedh rrugën e veprimit në rrugë dhe vetëm aty.

Lista e shkurtesave

GDN	–	Grupi Drejtues Ndërkombëtar
KCPD	–	Kapaciteti Civil për Planifikim dhe Drejtim
KSP	–	Komiteti për Siguri Politike
KVMD	–	Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike
PCN	–	Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (ang. ICR)
PESM	–	Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes
PSBE	–	Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
PSSP	–	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të përgjithshëm (të OKB-së)
SP/PL	–	Sekretari i Përgjithshëm/Përfaqësuesi i Lartë (i BE-së)
VPKBE	–	Veprimi i Përbashkët i Këshillit të BE-së
ZCN	–	Zyrja Civile Ndërkombëtare (ang. ICO)

HYRJE

Kosova po qeveriset nga dy misione ndërkombëtare, Zyra Civile Ndërkombëtare (ZCN) dhe EULEX-i, që të dyja me pushtet ekzekutiv për të cilin nuk japin përgjegjësi në Kosovë. Sipas letrës së Ban Ki-moon-it, EULEX-i tash do të vepron nën një ombrellë të Kombeve të Bashkuara bazuar në Rezolutën 1244. Detajet e kësaj marrëdhënie nuk janë ende të qarta. Nuk është e qartë po ashtu nëse Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar/Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (PCN/PSBE) do të jetë nën të njëjtën ombrellë.

1) EULEX

EULEX-i do t'i përgjigjet Javier Solana-s, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Përfaqësuesit të Lartë të BE-së, ndërsa anëtarët individual të stafit do të jenë të përgjegjshëm edhe para shteteve prej nga kanë ardhur. Kur kreu i EULEX-it do të përdor fuqitë e tij ekzekutive, ai do të duhet të konsultohet me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar (PCN). EULEX-i mund të punësojë njerëz nga vende brenda dhe jashtë BE-së, përfshirë edhe ato vende që nuk kanë njohur Kosovën.

Nëse EULEX-i vepron nën një ombrellë të UNMIK-ut, atëherë do jetë, siç po thuhet, "neutral karshi statusit" (*'status neutral'*) dhe do të jetë i përgjegjshëm në një mënyrë edhe para Këshillit të Sigurimit të OKB-së, si dhe BE-së, ndonëse kjo nuk është qartësuar ende.

Përpos udhëheqjes me policinë, institucionet ligjore dhe doganore të Kosovës, EULEX-i po ashtu do të zgjedh gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë si dhe do të vendosë se cilat raste do t'i gjykojnë këta të fundit. EULEX-i ka të drejtë të shpallë të pavlefshme vendimet e qeverisë së Kosovës dhe 'të marrë përsipër përgjegjësi të tjera, në mënyrë të pavarur ose në mbështetje të autoriteteve kompetente të Kosovës', si dhe të mbrojë ligjin, rendin publik dhe sigurinë.

2) Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN)

Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN), Pieter Feith, do t'i përgjigjet Grupit Drejtues Ndërkombëtar për pushtetin e tij të definuar në Marrëveshjen e Ahtisaarit, përderisa Javier Solana-s do t'i përgjigjet për pjesën e pushtetit të tij të definuar nga BE-ja. Zyra Civile Ndërkombëtare (ZCN) mund të punësojë në stafin e saj edhe njerëz nga vende brenda BE-së, që nuk kanë njohur Kosovën.

Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (ZCN) është autoriteti përfundimtar për interpretimin dhe zbatimin e Planit të Ahtisaarit. Përpos miratimit të të gjithë gjykatësve dhe prokurorëve të zgjedhur, si dhe emërimit dhe miratimit të pozitave kyçe në institucionet e Kosovës, ZCN-ja ka edhe fuqi ekzekutive korrigjuese. Këto fuqi mund të përfshijnë – por nuk kufizohen me - anulimin e ligjeve ose vendimeve të marra nga Kuvendi i Kosovës për të cilat PCN-ja gjykon se shkelin ose janë në kundërshtim me Marrëveshjen e Ahtisaarit apo sundimin e ligjit. Ai po ashtu mund të dënojë ose shkarkojë nga pozita cilindo zyrtar publik, 'ose të marrë masa të nevojshme', nëse ai gjykon që këta zyrtarë kanë kundërshtuar letrën ose frymën e Marrëveshjes si dhe/ose nëse ata kanë penguar punën e PCN-së ose EULEX-it.

3) UNMIK-u i 'rikonfiguruar'

Përfaqësuesi i ri Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) është diplomati italian Lamberto Zannieri dhe ky do t'i jep llogari Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Në letrën e tij Ban Ki-moon propozoi që OSBE-ja dhe EULEX-i të veprojnë nën një ombrellë të rikonfiguruar të UNMIK-ut (Pjesa III.13). Kjo ombrellë UNMIK-u do të jetë një mision neutral karshi statusit (Pjesa III.12). Mënyra e saktë e lidhjes së EULEX me UNMIK do të definohet gjatë diskutimeve të mëtuajtshme (Pjesa V.20)

Sipas propozimit të Ban Ki-moon-it (Pjesa IV.16), mandati i UNMIK-ut do të përfshijë:

- Vëzhgim dhe raportim
- Lehtësim të angazhimit të Kosovës në marrëveshje ndërkombëtare
- Lehtësim të dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit
- Kryerje funksionesh në lidhje me zbatimin e lëshimeve të bëra nga Ban Ki-moon-i ndaj Tadiqit

Bazimi ligjor i ombrellës së UNMIK-ut në Rezolutën 1244 dhe pozita e saj neutrale karshi statusit, janë në kundërtënie të drejtpërdrejtë me Kushtetutën e Kosovës. Mandati i tij në lidhje me propozimet për 'ndarje funksionale' mund të bie në konflikt të drejtpërdrejtë me kompetencat e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar (PCN) për mbikëqyrjen e zbatimit të Marrëveshjes së Ahtisaarit si dhe obligimit kushtetues të institucioneve të Kosovës për ta zbatuar këtë Marrëveshje.

4) Llogaridhënia

Nuk ekziston e drejta e apelimit kundër vendimeve të EULEX-it ose PCN-së.

Brenda institucioneve të Kosovës nuk ekziston kurrfarë mbikëqyrje për vendimet politike të marra nga PCN-ja ose EULEX-i.

PCN-ja dhe zyra e tij, ZCN-ja, si edhe EULEX-i, janë imunë si organizata, individë dhe pronë nga ndjekja penale në Kosovë. U takon vendeve dërguese që të ndërmarrin veprime ligjore kundër stafit ndërkombëtar që kryen shkelje kriminale dhe shkelje të të drejtave të njeriut në Kosovë. E njëjta rregull ka vlejtur edhe për stafin e UNMIK-ut.

Derisa ushtruesi i detyrës së Avokatit të Popullit (Ombudspersoni) të mos zëvendësohet nga një Avokat i Përhershëm i Kosovës, ky institucion ka akoma të drejtën e hetimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u. Paneli Këshilldhënës për të Drejtat e Njeriut ka hetuar shkelje të supozuara të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u që nga fillimi i vitit 2008. Përfundimet rekomanduese të panelit nuk përbëjnë detyrime për PSSP-në.

Përfundim

Kosova do të qeveriset nga tri misione ndërkombëtare (duke përfshirë KFOR-in):

- EULEX-i do t'i përgjigjet edhe UNMIK-ut (në një formë të padefinuar), edhe BE-së; Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar do t'i përgjigjet BE-së dhe Grupit Drejtues Ndërkombëtar. UNMIK-u do t'i përgjigjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Sigurimit.
- Që të dyja, OKB-ja dhe EULEX-i, do të jenë neutrale karshi statusit. Në ndërkohë, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar do t'i përgjigjet dy organizmave që përfshijnë anëtarë ose organizata, që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.
- Asnjë nga këto misione nuk u japin llogari në çfarëdo forme institucioneve të Kosovës.

Pjesa e Parë: Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN)

Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN) është autoriteti më i lartë civil politik në Kosovë. Ai është autoriteti përfundimtar me të drejtën e interpretimit të Marrëveshjes së Ahtisaarit. Ai ka rol udhëheqës në të garantuarit e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe në bashkërendim të aktiviteteve të pranisë ndërkombëtare në Kosovë, duke përfshirë edhe EULEX-in. Në mënyrë që ta zbatojë këtë Marrëveshje, PCN-ja ka fuqi ekzekutive korrigjuese mbi institucionet e Kosovës.

MANDATI

Pieter Feith është emëruar si Përfaqësues Civil Ndërkombëtar (PCN) nga Grupi Drejtues Ndërkombëtar mbi baza të Aneksit IX të Planit të Ahtisaarit, dhe si Përfaqësues Special i BE-së (PSBE) nga Këshilli i BE-së mbi baza të Veprimit të Përbashkët të Këshillit 5576/1/08. Këto dy pozita, PCN-ja dhe PSBE-ja, janë bashkuar në një pozitë të njohur si Përfaqësues Civil Ndërkombëtar (PCN).

1) Fuqitë dhe Përgjegjësitë: Marrëveshja e Ahtisaarit, Aneksi IX

Më 28 shkurt 2008, Grupi Drejtues Ndërkombëtar emëroi Pieter Feith-in si Përfaqësues Civil Ndërkombëtar, duke definuar kështu përgjegjësitë e tij sipas Aneksit IX të Marrëveshjes së Ahtisaarit. Këto përfshijnë kompetenca ekzekutive.

Sipas Aneksit IX, Pieter Feith ka fuqi:

Ta interpretojë Marrëveshjen e Ahtisaarit

- PCN-ja është 'autoriteti final në Kosovë për sa i përket interpretimit të aspekteve civile të Marrëveshjes' (Neni 2.1a, Aneksi IX dhe Neni 12.3, Parimet e Përgjithshme). Kjo Marrëveshje është dokumenti më i lartë ligjor në Kosovë. Ka 5 përparësi ndaj të gjitha masave të tjera ligjore, duke përfshirë edhe Kushtetutën e Kosovës (Kushtetuta, Neni 143).

T'i përdorë fuqitë korigjuese ekzekutive mbi institucionet e Kosovës që të garantojë zbatimin e Marrëveshjes:

- Ai mund të shpallë të pavlefshme ligjet ose vendimet e marra nga Kuvendi i Kosovës, nëse ai gjykon që ato shkelin ose janë në kundërshtim me Marrëveshjen ose me sundimin e ligjit. Këto masa korigjuese 'mund të përfshijnë, por nuk janë të kufizuara me, shpalljen e pavlefshme të ligjeve ose vendimeve të marra nga autoritetet e Kosovës' (Aneksi IX, Neni 2.1c).
- Ai mund të dënojë ose shkarkojë nga pozita cilindo zyrtar publik ose 'të marrë masa të nevojshme' në rastet kur zyrtarët që janë përgjegjës për dështime serioze ose të përsëritura për t'iu bindur letrës ose frymës së Marrëveshjes, dhe/ose kur këta kanë penguar punën e PCN-së ose EULEX-it (Aneksi IX, neni 2.1d).

T'i vëzhgojë institucionet e tjera ndërkombëtare të përfshira në zbatimin e Marrëveshjes:

- PCN-ja do të bashkërendojë, dhe ka të drejtë vëzhgimi, të rolit të akterëve ose organizatave të tjera ndërkombëtare në Kosovë, që janë të përfshira në zbatimin e të gjitha aspekteve civile të kësaj Marrëveshjeje (Aneksi IX, Neni 2.1e, Neni 12.5 Parimet e Përgjithshme).

Të emërojë zyrtarë të caktuar publikë:

- Auditorin e Përgjithshëm Ndërkombëtar
- Një përfaqësues ndërkombëtar në Bordin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Të miratojë emërimin e zyrtarëve të caktuar publikë:

- Gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë të përzgjedhur nga EULEX-i,
- Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Doganor,
- Drejtorin e Administratës Tatimore,
- Drejtorin e Thesarit,
- Drejtorin menaxhues të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës

Të mbikëqyr zhvillimin e institucioneve kosovare të sigurisë së brendshme

- PCN-ja do të mbikëqyr zhvillimin e një institucioni Kosovar të mbikëqyrjes civile të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) si dhe një agjencie të sigurisë së brendshme (Neni 2.4 dhe 2.5).

2) Kompetencat dhe Përgjegjësitë: Veprimi i Përbashkët i Këshillit të BE-së 5576/1/08

Me 12 shkurt 2008, Këshilli i BE-së, si trupi kryesor vendimmarrës i BE-së, e ka emëruar Pieter Feith-in si Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë (PSBE), duke e përkufizuar mandatin e tij në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit të BE-së 5576/1/08 (në vijim VPKBE). Në kontrast me vetë kompetencat ekzekutive speciale të përkufizuara për PCN-në në Planin e Ahtisaarit, PSBE-ja është përshkruar më shumë si një rol këshillues për institucionet e Kosovës dhe EULEX-in, dhe si një koordinator për praninë ndërkombëtare në Kosovë.

Në bazë të Nenit 3 të VPKBE, Pieter Feith ka mandat që:

- T'i ofrojë këshilla dhe përkrahje BE-së në procesin politik
- Të promovojë koordinimin e përgjithshëm politik të BE-së në Kosovë
- Ta pajisë EULEX-in me drejtim politik, përfshirë këtu aspektet politike të përdorimit të përgjegjësisë ekzekutive të tij
- Të sigurojë konsistencë dhe koherencë të misioneve të BE-së në marrëdhëniet me publikun
- Të bëjë drejtimin politik dhe operacional të Kreut të Ekipit Planifikues të BE-së
- Të kontribuojë në zhvillimin dhe konsolidimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale në Kosovë, në përputhje me politikën dhe parimet e BE-së për të drejtat e njeriut.

PSBE/PCN nuk ka autoritet ekzekutiv obligues mbi EULEX-in:

PSBE/PCN 'duhet ta pajisë me drejtimin politik lokal Kreun e Misionit Evropian të Sundimit të Ligjit (EULEX KOSOVO), përfshirë aspektet politike të çështjeve të lidhura me përgjegjësitë ekzekutive' (Neni 12, VPKBE)

A MUNDEN SHTETET QË NUK E PRANOJNË TË DËRGOJNË STAF TË TYRE TË PUNOJË NË ZCN?

PO

I vetmi kusht është që personeli ndërkombëtar duhet të jetë nga vendet e BE-së

- Shtet anëtarë të BE-së mund të dërgojnë staf që të punojë në mision dhe janë përgjegjëse për t'i paguar rrogat e tyre. I gjithë stafi ndërkombëtar duhet të jetë nga vendet e BE-së (Neni 6, VPKBE)
- PCN/PSBE e ka të drejtën që ta caktojë ekipin e tij në konsultim me udhëheqjen e BE-së, SP/PL dhe Komisionin (Neni 6, VPKBE)

LLOGARIDHËNIA E JASHTME DHE ZINXHIRI KOMANDUES

Grupi Drejtues Ndërkombëtar (GDN): PCN i jep llogari këtij grupi *ad hoc* i cili nuk ka bazë legale ose procedura formale të vendimmarrjes

- PCN-ja është i emëruar nga Grupi Drejtues Ndërkombëtar i cili përbëhet nga: Franca, Gjermania, Italia, Rusia, Britania e Madhe, ShBA-të, Bashkimi Evropian, Komisioni Evropian, NATO-ja (Neni 4.1, Aneksi IX). Në muajin maj, GDN-ja i ka aprovuar gjashtë anëtarë të rinj: Bullgarinë, Estoninë, Irlandën, Letoninë, Luksemburgun dhe Poloninë. Të gjitha këto vende, me përjashtim të Ruisë, BE-së, Komisionit të BE-së dhe NATO-s, e kanë pranuar pavarësinë e Kosovës.
- Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së është menduar ta aprovojë emërimin e PCN-së (Neni 4.1, Aneksi IX)
- PCN-ja i raporton drejtpërdrejt GDN-së, por ai po ashtu i kryeson mbledhjet e tij. (Neni 4.2, Aneksi IX)
- GDN-ja e përcakton se kur duhet të përfundojë mandati i PCN-së mbi bazën nëse GDN-ja e vlerëson që Përcaktimi/Marrëveshja është zbatuar (Neni 5.2)
- PCN-ja i jep llogari GDN-së për fuqitë ekzekutive që ai i derivon prej Marrëveshjes së Ahtisaarit.

BE-ja (Sekretari i Përgjithshëm/Përfaqësuesi i Lartë) dhe Komiteti për Sigurinë Politike: PSBE-ja i jep llogari Javier Solana-s

- PSBE-ja vepron me autoritetin dhe nën drejtimin operacional të Javier Solana-s, i cili e mban pozitën e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri si dhe të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të BE-së.
- Përfaqësuesi Special i BE-së e pranon drejtimin politik dhe strategjik nga Komiteti për Siguri Politike (KSP) i BE-së i cili e monitoron politikën e sigurisë dhe të jashtme të BE-së. Është i përbërë nga drejtorët politik të ministrive të jashtme të shteteve anëtare dhe ka kontrollin politik të 'operacioneve për menaxhimin e krizave'. Roli i tij është të mundësojë lidhjen ndërmjet PSBE-së dhe Këshillit të BE-së i cili e ka caktuar atë (Neni 4, VPKBE)
- Nga PSBE-ja kërkohet që t'i raportojë rregullisht SP/PL-së si dhe KSP-së gojarisht dhe me shkrim (Neni 11)
- PSBE i jep llogari BE-së për kompetencat e përcaktuara në VPKBE.

Shtete anëtare të BE-së

- Staf i mbështetës i ZCN-së 'duhet të mbetet nën autoritetin administrativ të shteteve anëtare që i dërgojnë ose institucionit të BE-së, dhe duhet t'i kryejnë detyrat e tyre dhe të veprojnë në interes të misionit të PSBE-së.' (Neni 6)

Komisioni i BE-së

PSBE-ja përfundimisht i jep llogari Komisionit të BE-së për buxhetin e alokuar PSBE-së për vitin e parë të operacionit: 380.000 euro nga BE-ja. (Neni 5, EUCJ)

PJESA 2: EULEX-i

EULEX-i është misioni i BE-së përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjit, rendit dhe sigurisë në Kosovë. Ai do të operojë në fushën e sundimit të ligjit, veçanërisht në gjyqësi, polici, kontroll të kufirit, dogana dhe shërbime korrektuese. Për ta zbatuar ligjin, mbajtur rendin dhe forcuar sigurinë, EULEX-i nën udhëzimet e PCN-së mund ta përdorë pushtetin ekzekutiv korrektues ndaj institucioneve të Kosovës. Sipas letrës së Ban Ki-moon-it, EULEX-i do të operojë nën ombrellën e UNMIK-ut si mision 'neutral ndaj statusit'. Se si do të lidhet me UNMIK-un, nuk është qartësuar ende.

MANDATI

Gjenerali francez, Yves de Kermabon, është emëruar si Kryesues i Misionit të EULEX-it me Veprimin e Përbashkët të Këshillit të BE-së (VPKBE) 5928/08, të datës 4 shkurt 2008. Objektivat e EULEX-it janë përshkruar në VPKBE, përderisa kompetencat e tij ekzekutive rrjedhin nga Aneksi IX i Marrëveshjes së Ahtisaarit. Ky pushtet ekzekutiv ushtrohet nën udhëzimet e PCN-së

1) Veprimi i Përbashkët i Këshillit të BE-së 5928/08

EULEX-i është autorizuar të veprojë në Kosovë në përputhje me Rezolutën 1244

Për

- 'Mbikëqyrjen e transferimit të autoritetit prej institucioneve të përkohshme të Kosovës te institucionet e themeluara sipas marrëveshjes politike'
- 'Zbatimin e ligjit civil dhe mbajtjen e rendit, përfshirë krijimin e forcave policore vendore, dhe në ndërkohë, përmes dislokimit të personelit policor ndërkombëtar për të shërbyer në Kosovë' (Preambula, 1)

EULEX-i është themeluar si 'operacion për menaxhimin e krizave' nga BE-ja për ta forcuar 'stabilitetin'

- 'Ka nevojë për t'i parandaluar, në bazë humanitare, shpërthimet e mundshme të dhunës, aktet e përndjekjes dhe frikësimit në Kosovë' (Preambula, 3)
- 'Më 11 dhjetor të vitit 2006, Këshilli ka miratuar Konceptin e Menaxhimit të Krizave për operacionin e mundshëm të BE-së për menaxhimin e krizave në fushën e sundimit të ligjit dhe fushat e tjera të mundshme në Kosovë' (Preambula,5)
- Misioni është pjesë e politikës së BE-së për ta 'luajtur rolin kryesor në forcimin e stabilitetit në rajon' (Preambula, 7)
- EULEX-i 'do të ndërhyjë në situatat që mund t'i përkeqësojnë apo dëmtojnë objektivat e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë' (Preambula, 14)

EULEX-i do t'i monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet e rendit dhe të ligjit në Kosovë:

- EULEX-i është mision i cili do të 'udhëhiqet sipas politikës evropiane të sigurisë dhe mbrojtjes (PESM)' (Neni 2)
- EULEX-i do ta 'përbush mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, ndërkohë që do t'i mbajë disa përgjegjësi ekzekutive' (Neni 2)
- Ai do të ndihmojë në 'përkujdesjen që këto institucione të jenë të lira nga ndërhyrjet politike dhe t'i përmbahen standardeve të pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikave më të mira evropiane' (Neni 2)
- Ai do të kujdeset që 'rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimit ndëretnik, krimit financiar/ekonomik dhe krimeve tjera serioze të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe sforcohen me rregull', dhe, kur është e përshtatshme, nga zyrtarë ndërkombëtarë me autoritetet e Kosovës apo pavarësisht nga to (Neni 3.d)
- EULEX-i do të përbëhet nga misioni i policisë, ai i gjyqësisë si dhe misioni i doganave, që do të veprojnë brenda institucioneve të Kosovës, e që janë pjesë e një misioni të përbashkët të PESH-së (Neni 6). Personeli do të vendoset brenda Shërbimit Policor të Kosovës, ministrive relevante, gjyqësisë, Agjencisë Kosovare të Pronës, Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Shërbimit Doganor të Kosovës.

EULEX-i do të ketë të drejtë ta përdorë pushtetin ekzekutiv:

- Do të 'kujdeset për mbajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendit publik dhe sigurisë, përfshirë këtu përmes prapakhimit apo anulimit të vendimeve operacionale të marrura nga autoritetet kompetente të Kosovës, siç është nevoja dhe pas konsultimit me autoritetet relevante civile ndërkombëtare në Kosovë,' (Neni 3.b)
- EULEX-i ka të drejtë të '*marrë mbi vete përgjegjësi tjera, pavarësisht apo në përkrahje të autoriteteve kompetente të Kosovës, për të siguruar mbajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendit publik dhe sigurisë, pas konsultimit me agjencitë relevante të Këshillit'* (Neni 3.h)

2) Pushteti dhe Përgjegjësitë: Marrëveshja e Ahtisaarit, Aneksi IX

Sipas Aneksit IX të Planit të Ahtisaarit, EULEX-i i ka kompetencat e poshtëshënuara, të cilat i ushtron nën udhëzimin e PSBE/PCN-së.

Sistemi ligjor (Neni 2.3)

- Ka autoritetin që të kujdeset që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimet të organizuar, korrupsionit, krimet ndëretnik, krimet financiar/ekonomik, rastet që kanë të bëjnë me pronën dhe krimet tjera serioze do të hetohen, ndiqen, gjykoen dhe se vendimet do të zbatohen me rregull. Hetimet mund të bëhen nga hetuesit, prokurorët ose gjykatësit ndërkombëtarë, që veprojnë bashkërisht me autoritetet e Kosovës, apo pavarësisht nga to (Neni 2.3a,b,c,d)
- Kreu i EULEX-it ka të drejtë të përcaktojë kritere sipas të cilave do të përzgjedhen rastet për prokurorët dhe gjykatësit ndërkombëtarë (Neni 2.3, b,c)
- EULEX-i ka autoritetin të monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë në të gjitha fushat që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit (Neni 2.3g)

Kufizime të padefinuara të pushtetit të sigurisë

- EULEX-i ka autoritetin të *marrë mbi vete përgjegjësi tjera, pavarësisht apo me përkrahje të autoriteteve kompetente të Kosovës*, për të siguruar mbajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendit publik dhe sigurisë (Neni 2.3 e). Nuk është qartësuar nëse ky pushtet do të përdoret vetëm në raste emergjente apo do të jetë proces standard i qeverisjes.

Pushteti korrektues

- Në konsultim me PCN-në, EULEX-i ka autoritetin t'i prapakthejë apo anulojë vendimet operacionale të marra nga autoritetet kompetente të Kosovës, për t'u siguruar mbajtja dhe promovimi i sundimit të ligjit, i rendit publik dhe sigurisë; (Neni 2.3f)

A MUND TË DËRGOJNË SHTETET QË NUK E NJOHIN KOSOVËN PERSONEL NË EULEX?

PO

Personeli ndërkombëtar në EULEX nuk duhet të jetë domosdoshmërisht nga BE-ja

- EULEX-i ka autoritetin të emërojë në mision personel, përfshirë gjykatës dhe prokurorë, të cilët pastaj miratohen nga PCN-ja (Neni 2.3i, Aneksi IX; Neni 4, VPKBE)
- Shumica e personelit do të delegohen nga shtetet anëtare apo nga institucionet e BE-së të cilët paguajnë koston e pagave të tyre, etj. (Neni 9.2)
- EULEX-i po ashtu mund të rekrutojë personel ndërkombëtar dhe vendor në bazë kontraktuese (Neni 9.3)

- Shtetet e treta po ashtu mund të delegojnë personel në EULEX, nëse nuk merren aplikacione të kualifikuara nga shtetet anëtare (Neni 9.4). Në Nenin 13, i cili i dedikohet shteteve të treta, ky kusht nuk është përfshirë. Ai thotë se shtetet e treta mund të kontribuojnë në EULEX përderisa i paguajnë pagat e personelit të tyre.

Shtetet e treta të cilat dërgojnë personel ndërkombëtar në EULEX, do t'i kenë të drejtat e njëjta në menaxhimin e përditshëm të EULEX-it sikur shtetet anëtare të BE-së

- 'Shtetet e treta që kontribuojnë në EULEX në Kosovë do të kenë të drejtat dhe obligimet e njëjta në menaxhimin e përditshëm të EULEX-it në Kosovë sikur vendet anëtare që marrin pjesë në të' (Neni 13.2). Pjesëmarrja e tyre duhet të bëhet 'pa paragjykuar autonominë vendimmarrëse të BE-së' (Neni 13.1).

I gjithë personeli ndërkombëtar i deleguar do të mbetet nën komandën e plotë të shtetit dërgues:

'I gjithë personeli i deleguar do të mbetet nën komandën e plotë të autoriteteve kombëtare të shtetit delegues ose institucionit të BE-së. Autoritetet kombëtare do ta transferojnë kontrollin operativ të personelit, ekipeve dhe njësive të tyre në Komanduesin Civil të Operacionit (Neni 7.4, VPKBE)

LLOGARIDHËNIA E JASHTME DHE ZINXHIRI KOMANDUES

BE-ja (Sekretari i Përgjithshëm/Përfaqësuesi i Lartë) dhe Komiteti për Politikën e Sigurisë: EULEX-i i jep llogari Javier Solana-s

- EULEX-i është nën kontrollin politik dhe drejtimet strategjike të tre organeve të BE-së.
 - Komanda strategjike dhe kontrolli i EULEX-it e ka selinë në Bruksel në të ashtuquajturën Kapaciteti Civil për Planifikim dhe Drejtim (KCPD). Komanduesi Civil i Operacionit të KCPD-së është Kees Klompenhauer.
 - KCPD-ja vepron nën autoritetin e Komitetit të BE-së për Politikë dhe Siguri (KPS) dhe nën autoritetin final të Javier Solana, SP/PL. (Neni 7)
- Këshilli i BE-së vendos, nën rekomandimet e Solanës, se kur do të përfundojë misioni i EULEX-it. (Neni 12.2)
- Komanduesi Civil i Operacionit, Klompenhauer, i ofron këshilla dhe përkrahje teknike kreut të misionit, Yves de Kermabon (Neni 7.2 VPKBE)
- Kreu i misionit, Yves de Kermabon, komandon dhe kontrollon personelin dhe resurset e EULEX-it (Neni 8)
- Komanduesi Civil i Operacionit, Klompenhauer dhe PSBE-së (Pieter Feith) duhet ta konsultojnë njëri-tjetrin siç kërkohet (Neni 7.6)
- Kreu i misionit, Yves de Kermabon merr udhëzime për politikën lokale nga PSBE-ja përsa i përket aspektit politik të përdorimit të pushtetit ekzekutiv (Neni 8.8)

Shtetet anëtare

- I tërë personeli i deleguar mbasin nën komandën e plotë të autoriteteve kombëtare të shteteve deleguese ose të institucioneve të BE-së. Autoritetet kombëtare do ta transferojnë kontrollin operativ të personelit, ekipeve dhe njësive të tyre në Komanduesin Civil të Operacionit. (Neni 7.4 VPKBE)

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së dhe Këshilli i Sigurimit

- Sipas letrës së Ban Ki-moon-it, EULEX-i do të veprojë nën ombrellën e UNMIK-ut. Ende nuk është definuar se në çfarë mënyre do ta ndikojë kjo zinxhirin komandues dhe llogaridhënien.

PJESA 3: PRIVILEGJET DHE IMUNITETET NGA LLOGARIDHËNIA E BRENDSHME


Të gjithë të punësuarit e ZCN-së dhe EULEX-it, përfshirë familjet e tyre, si dhe punonjësit ndërkombëtarë të emëruar nga PCN-ja, përfshirë zyret dhe arkivat e tyre, kanë imunitet diplomatik

- Kosova do t'ia jep zyrës së PCN-së dhe PSBE-së, si dhe objekteve të tyre, arkivave, dhe pronës tjetër, si dhe anëtarëve profesionalë të stafit të tij, përfshirë familjet e tyre, si dhe atyre profesionistëve ndërkombëtarë të emëruar nga PCN-ja privilegjet dhe imunitetet e njëjta me ato që gëzohen sipas Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (KVMD) (Neni 4.6 (a,b,c) Aneksi IX)
- KVMD thotë që imuniteti diplomatik nuk i përjashton zyrtarët nga juridiksioni i vendeve prej nga vijnë, ose prej juridiksionit civil dhe administrativ të gjykatave të Kosovës, në rastet specifike që kanë të bëjnë me pronën, suksesionin dhe aktivitetin profesional ose komercial jashtë funksionit formal zyrtar (Neni 31)
- KVMD ia rezervon të drejtën Qeverisë së Kosovës që 'në çdo kohë dhe pa pasur nevojë ta shpjegojë vendimin e vet, ta njoftojë shtetin dërgues se kreu i misionit ose cilido anëtar i personelit diplomatik të misionit është *persona non grata*, ose që cilido anëtar i misionit është i papranueshëm. Në cilindo prej këtyre rasteve, shteti dërgues, do ta kthejë prapa personin në fjalë, apo t'i pezullojë funksionet e tij brenda misionit, varësisht nga përshtatshmëria me rrethanat'. Personi mund të shpallet *non grata* ose i papranueshëm para se të arrijë në territorin e shtetit pranues (Neni 9)
- Për personelin e EULEX-it është specifikuar që shteti apo institucioni i BE-së që e ka deleguar anëtarin e personelit, do të jenë përgjegjës për përgjigje ndaj çfarëdo kërkesë që ka të bëjë me ta. Shteti apo institucioni i BE-së në fjalë do të jetë përgjegjës për ndërmarrjen e çfarëdo veprimi kundër personit të deleguar në mision. (Neni 10.2, EULEX VPKBE) Kreu i misionit është përgjegjës për kontrollin disiplinor përmbi personelin tjetër të padeleguar (Neni 8.6, EULEX VPKBE)

Nuk ka mbikëqyrje brenda Kosovës për pushtetin ekzekutiv korrektues të PCN-së

- PCN-ja ka autoritetin të themelojë mekanizmin i cili e shqyrton përdorimin e pushtetit të tij dhe ato të PSBE-së, por me kusht që kjo mbikëqyrje të mos paragjykojë privilegjet dhe imunitetin që i gëzon PCN-ja dhe PSBE-ja sipas kësaj Marrëveshje (Neni 2.6 Aneksi IX). Ky mekanizëm nuk është definuar e as që është themeluar.

ZINXHIRI KOMANDUES



LLOGARIDHËNIA DHE PËRGJEGJËSIA

HYRJE

Përkundër shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ne edhe më tej do të qeverisemi nga një administratë ndërkombëtare e pazgjedhur nga ne dhe që nuk na jep llogari, e cila tash nuk përbëhet nga një por nga tri misione: Zyra Civile Ndërkombëtare (angl. ICO), EULEX-i dhe UNMIK-u. Vetë ekzistenca e këtyre misioneve si administrata ekzekutive na e mohon të drejtën për ta gëzuar pavarësinë dhe sovranitetin e shpallur më 17 shkurt: të drejtën tonë për liri nga Serbia dhe për një qeveri demokratike. Përbërja e këtyre misioneve do të na largojë edhe më tepër nga ky qëllim: mandatet e tyre janë në kundërshtim me interesat e Kosovës dhe (këto misione) për veprimet e veta u përgjigjen qarqeve ndërkombëtare, që janë të ndara në mes të shteteve të cilat na kanë njohur ose jo. Ne nuk i kundërvihemi udhërrëfimit dhe ekspertizës ndërkombëtare, por jemi kundër qeverisjes tonë nga ana e ndërkombëtarëve.

Mandatet e tyre janë në kundërshtim me interesat tona:

- UNMIK-u do të mbetet këtu për t'i ndihmuar negociatat në mes të Prishtinës e Beogradit dhe për ta zbatuar planin për 'ndarje funksionale', ashtu siç është propozuar në letrën e Ban Ki-moon-it.
- ZCN-ja është këtu për ta zbatuar Marrëveshjen e Ahtisaarit, i cili propozoi ndarje etnike dhe territoriale, por që tash duket të jetë në kundërshtim me konsepcionet edhe më të rënda të Ban Ki-moon-it ndaj Beogradit.
- EULEX-i është këtu për ta zbatuar sistemin e rendit dhe ligjit në Kosovë, të cilit nuk do t'i nënshtrohet vetë. Meqë është 'neutral karshi statusit', ai nuk do ta njohë kushtetutën e Kosovës në bazë të së cilës synohet të zbatohet sistemi i rendit dhe i ligjit!

Këto misione japin llogari para qarqeve të jashtme ndërkombëtare me lojalitet kundërthënës:

- EULEX-i UNMIK-ut (në formë të padefinuar) si dhe BE-së
- PCN-ja do t'i jep llogari BE-së si dhe Grupit Drejtues Ndërkombëtar
- UNMIK-u do t'i jep llogari Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Sigurimit
- Si OKB-ja ashtu edhe BE-ja, do të jenë 'neutrale ndaj statusit', që do të thotë se ata nuk e njohin shpalljen e pavarësisë
- BE-ja, Këshilli i Sigurimit i OKB-së dhe Grupi Drejtues - të gjitha përfshijnë në radhët e tyre anëtarë ose organizata, të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

Asnjëri nga këto misione nuk jep llogari në asnjë mënyrë para institucioneve të Kosovës.

Ky dokument shpalos propozimin e Lëvizjes VETËVENDOSJE! për atë se çka është minimumi që do të duhej të bënin institucionet e Kosovës në mënyrë që ky sistem i padrejtë i administratave ndërkombëtare të paktën të mund të merret në përgjegjësi për veprimet e veta dhe vendimet mbi politikën në Kosovë.

PUSHTETET E PAQARTA EMERGJENTE

Si PCN-ja ashtu edhe EULEX-i kanë të drejtë t'i zgjerojnë pushtetet e tyre ekzekutive sipas nevojës, derisa rrethanat në të cilat ata mund ta bëjnë këtë apo masat të cilat mund t'i ndërmarrin, nuk janë qartësuar.

- Përveçse mund t'i anulojë vendimet operacionale të Qeverisë së Kosovës, EULEX-i mund të *'marrë mbi vete përgjegjësi të tjera, në mënyrë të pavarur ose në mbështetje të autoriteteve kompetente të Kosovës.* (Aneksi IX, Artikulli 2.3, Plani i Ahtisaarit)
- Pushtetet e PCN *'mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në 'anulimin e ligjeve ose vendimeve të Kuvendit të Kosovës, si dhe ai ka të drejtë t'i sanksionojë ose t'i përjashtojë zyrtarët 'ose të ndërmarrë masa të tjera të nevojshme'* (Aneksi IX, Artikulli 2.1, Plani i Ahtisaarit)

MOSLLOGARIDHËNIA

Sipas rasteve të mëparshme të paraqitura në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut, ka pak gjasa që ZCN-ja ose EULEX do të mund t'i nënshtroheshin juridiksionit të kësaj gjykate, ngase llogari për veprimet e veta jep organizata e jo shtetet. (Shih rastin *Sheremeti kundër Norvegjisë; Behrami kundër Francës; dhe Alimuhamet kundër Greqisë*). Në Bosnje, më 2006, Gjykata Kushtetuese vendosi se mënyra në të cilën Përfaqësuesi i Lartë i BE-së i kishte përjashtuar zyrtarët publikë nga puna, kishte qenë shkelje e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), ngase nuk ishin paraqitur dëshmi para një autoriteti të pavarur dhe nuk ishte përfshirë e drejta për ankesë. Gjykata vendosi që institucionet e Bosnjes ishin të detyruara t'i nënshtroheshin Kushtetutës së Bosnjes, e cila bazohet në KEDNJ. Si kundërpërgjigje Grupi Drejtues Ndërkombëtar ua rikujtoi institucioneve të Bosnjes se detyrimet e tyre ndaj Dejttonit ishin parësore.

I vetmi mekanizëm për t'i marrë në përgjegjësi për veprimet e veta individët e caktuar nga radhët e stafit ndërkombëtar është përmes shteteve të tyre amë. Siç tregon qartë rasti i 10 shkurtit 2007, drejtësia nuk mund të varet nga mënyra se si një shtet tjetër e koncepton drejtësinë. Rumania asnjëherë nuk ka ndërmarrë asnjë masë ligjore kundër policëve të njësisë rumune të policisë së OKB-së, të dyshuar për vrasjen e Mon Balajt dhe Arben Xheladinit.

Kuvendi i Kosovës nuk ka të drejtë t'i hedhë poshtë vendimet e PCN-së ose të EULEX-it. As zyrtarët e sanksionuar ose të shkarkuar nga pozitat e tyre nga PCN-ja nuk kanë ndonjë mekanizëm për ta zbrapsur një vendim të tillë.

Ombudspersoni nuk ka kompetenca për t'i hetuar ankesat për shkelje të të drejtave të njeriut qoftë nga ana e PCN-së apo EULEX-it. Ai ka të drejtë t'i hetojë shkeljet nga ana e UNMIK-ut derisa të emërohet Ombudspersoni i përhershëm i Kosovës.

Që nga fillimi i vitit 2008, Paneli Këshillues për të Drejtat e Njeriut pranë UNMIK-ut ka filluar t'i shqyrtojë ankesat kundër UNMIK-ut (ai është themeluar sipas Rregullores 2006/12 në mars të vitit 2006). PSSP nuk ka obligim ligjor t'i marrë parasysh rekomandimet e këtij Paneli.

(SI) TË JAPIN LLOGARI

PCN-ja dhe EULEX-i thonë se ata nuk janë një 'Protektorat i BE-së.' Argumenti i tyre është se ata thjesht janë këtu për të 'ndihmuar' dhe 'këshilluar' institucionet e Kosovës në mënyrë që ta forcojnë demokracinë, ligjin dhe rendin. Por pushtetet dhe përgjegjësitë që kanë këto misione tregojnë qartë se ato janë misione ekzekutive, të cilat nuk mund të merren në përgjegjësi dhe janë mbi ligjin të cilin kanë ardhur për ta zbatuar këtu. Brenda Kosovës nuk ekziston mekanizëm me anë të të cilit populli i Kosovës do të mund t'i merrte ato në përgjegjësi për politikatat të cilat i zbatojnë dhe veprimet të cilat i kryejnë. Ato në thelb janë misione autoritare. Ato na e zbatojnë një ligj të cilin vetë nuk e respektojnë. Nëse ligji të cilin e zbaton EULEX-i është i mirë për popullin e Kosovës, atëherë ai patjetër do të duhej të ishte i mirë edhe për ta.

Lëvizja VETËVENDOSJE! e kundërshton çfarëdo pranie ndërkombëtare në Kosovë me autoritet për të qeverisur. E vetmja zgjidhje e drejtë është që Kosovës t'i lejohet të udhëhiqet nga Kuvendi i saj sovran i dalë nga zgjedhjet e lira. Por, meqë një gjë e tillë po na mohohet dhe këto misione tashmë janë duke na qeverisur, institucionet e Kosovës duhet që të paktën të kërkojnë që ato të merren në përgjegjësi për veprimet e veta dhe vendimet e marra mbi politikatat në Kosovë.

Ne propozojmë masat në vijim:

1) Përgjegjësi për vendimet mbi politikatat dhe vendimet operacionale

- a) PCN/PSBE dhe shefi i EULEX duhet të merren në pyetje para Kuvendit të Kosovës një herë në javë
- b) Të gjithë deputetët e Kosovës duhet të kenë të drejtë t'u dërgojnë pyetje me shkrim ZCN-së dhe EULEX-it lidhur me çështjet brenda kompetencave të tyre. ZCN dhe EULEX duhet të obligohen të përgjigjen në këto pyetje brenda tri ditësh.
- c) Duhet të themelohet një *Komision i Pavarur për Përgjegjësi mbi Politikatat* për ta monitoruar rolin e PCN-së dhe EULEX-it në menaxhimin e politikave dhe atë operacionale në Kosovë. Anëtarët e këtij komisioni duhet të jenë nga shoqëria kosovare.

2) Transparencë

- a) ZCN-ja dhe EULEX-i ta hapin një bibliotekë publike në të cilën dokumentet zyrtare do të jenë në dispozicion të opinionit të gjerë për lexim brenda një kornize të përcaktuar kohore. Një kopje e të gjitha dokumenteve të arkivuara të ZCN-së dhe EULEX-it duhet të mbesin në arkivat e Kosovës.

3) Pavarësi të gjyqësisë

- a) Një Komision i Përgjegjës në Gjyqësi të themelohet brenda Këshillit Gjyqësor. Ky komision nuk duhet të përfshijë gjykatës ndërkombëtarë.
- b) Emërimi i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë të zgjedhur nga EULEX-i duhet të aprovohet nga ana e Komisionit të Kosovës për Përgjegjësi në Gjyqësi.
- c) Gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë duhet të mbikëqyren nga Komisioni i Kosovës për Përgjegjësi në Gjyqësi.
- d) Përzgjedhja e rasteve për gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë duhet të monitorohet nga ana e Komisionit të Kosovës për Përgjegjësi në Gjyqësi.

4) Përgjegjësi për shkelje të të drejtave të njeriut

- a) Ombudspersonit t'i jepen kompetenca për t'i hetuar shkeljet e mundshme nga PCN-ja dhe EULEX-i. Aty ku institucioni i Ombudspersonit vendos se është bërë një shkelje, përfundimet e tij duhet ta obligojnë ligjërisht PCN/EULEX dhe shtetin përkatës amë.
- b) Në bazë të përfundimeve të Ombudspersonit, institucionet e Kosovës duhet të kenë mundësi t'i ndërmarrin masat përkatëse:
 - Komisioni për Përgjegjësi në Gjyqësi mund të kërkojë që imuniteti i të akuzuarit të hiqet në mënyrë që ai ose ajo të mund të ndiqet penalisht në Kosovë.
 - Komisioni për Përgjegjësi në Gjyqësi mund të kërkojë që shteti (dërgues) amë të obligohet ta përndjekë penalisht të akuzuarin në vendin e tyre në bazë të dokumentacionit mbi rastin që do t'u dërgohej atyre.
 - Kuvendi i Kosovës mund të kërkojë që i akuzuari të përjashtohet nga Kosova në bazë të Nenit 9 të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike si *persona non grata*.

5) Përgjegjësi për shkelje penale

- a) Nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm se është kryer një krim nga një anëtar i personelit të ZCN-së ose EULEX-it, Komisioni për Përgjegjësi në Gjyqësi dhe Kuvendi duhet të kenë mundësi t'i zbatojnë të njëjtat masa që janë paraqitur në pikën 4.b
 - Komisioni për Përgjegjësi në Gjyqësi mund të kërkojë që imuniteti i të akuzuarit të heqet, në mënyrë që ai ose ajo të mund të ndiqet penalisht në Kosovë
 - Komisioni për Përgjegjësi në Gjyqësi mund të kërkojë nga shteti amë (dërgues) të obligohet ta përndjekë penalisht të akuzuarin në vendin e tij/saj në bazë të dokumentacionit mbi rastin që do të dërgohej atje.
 - Kuvendi i Kosovës mund të kërkojë që i akuzuari të përjashtohet nga Kosova në bazë të Nenit 9 të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Ndërkombëtare si *persona non grata*.